

THOMA TURTULLI DHE MIRËBËRËS TË TJERË TË ARSIMIT NË KORÇË (1912-1939)

Qysh në kohët më të hershme Korça me rrethinat e saj kanë rënë në sy për fenomenin e mirëbërësisë në të gjithë lëmenjtë e jetës. Posaçërisht korçarët, janë dalluar për mirëbërësi në fushën e arsimit. Ndër mirëbërësit e saj, dallohet Thoma Turtulli, i cili shkriu shumë nga pasuria e tij për shkolla, biblioteka, spitale e kisha.

Thoma Turtulli u lind në qytetin e Korçës në vitin 1865. I ati i tij, Koci i Ndrios-Gozhdaxhiu i zbritur nga Vithkuqi, kishte rënë në Korçë dhe kishte nisur tregtinë, duke u bërë nga më të dalluarit e qytetit, si biznesmen i aftë dhe njeri i drejtë. "I tërë tregu kishte besim tek ai, muhamedanë e të krishterë, të qytetit e të fshatit"¹

I biri, Thomai, i hyri shpejt tregtisë, qysh në moshë të re dhe në gjurmët e të atit, nisi shpejt të bëhet i suksesshëm. Qysh në vitin 1885, firma tregtare "Vëllazëria Turtulli" i kishte kaluar kufijtë shqiptarë dhe kishte krijuar degë në Selanik, Manastir dhe gjetiu. Erdhi një kohë që firma tregtare Turtulli u bë magazinë e madhe universale.²

Karakteri i qëndrueshëm, përvoja në tregti jo vetëm me shqiptarë, por dhe me të huaj, si edhe veprimtaria e njohur atdhetare e trevës së Korçës, e kishin bërë Thoma Turtullin jo vetëm të dalluar në tregti, por edhe një atdhetar veprimtar. Në eksodin e korçarëve më 1919, kur u hap lajmi se Korça do të invadohej nga andartët grekë, Thoma Turtulli, ndër të parët u largua familjarisht, së bashku me familje të tjera korçare, të cilat shkuan nëpër Europë të sensibilizonin botën e jashtme për rreziqet të cilat i vinin atdheut të tyre, posaçërisht Korçës, nga të huajt e, në mënyrë të veçantë, nga shovinizmi grek. Në vitin 1921 në Korçë u krijua "Grupi politik i Korçës", qëllimi i të cilit, ishte "bashkimi i gjithëmbarshtëm, forcimi i shtetit dhe përparimi i popullit dhe i kombit shqiptar përbrenda kufirit të drejtësisë dhe të njësisë së vërtetë të të gjithë nënshtetasve shqiptarë".³

Grupi angazhohej posaçërisht, se do të përpiquej për zhvillimin kulturor dhe ekonomik të qarkut të Korçës. Pleqësia e grupit përbëhej nga Koço Kota, kryetar, Qani Bej Dishnica, n/kryetar, Sulejman Mborja, arkëtar, Nuçi Kondilli, sekretar dhe Thoma Turtulli e Adem Bej Vila, këshilltarë. Dera e madhe qytetare "Turtulli", ishte përfshirë familjarisht në lëvizjen atdhetare të qarkut të Korçës. Shoqëria patriotike e zonjave të Korçës "Perëndia", që u themelua në vitin 1919, Erasti Grigor Turtullin e kishte zgjedhur sekretare.

Vepra mirëbërëse e familjes Turtulli, sipas të dhënave të deritanishme, nis në vitin 1921, kur Korçën e vizitoi miku i shqiptarëve, francezi Justin Godart. Ai bëri edhe një vizitë në jetimoren e Korçës. Me atë rast, "zonja e Thoma Turtullit u solli jetimëve një paqetë me kufeta të mira".⁴

Sipas traditës kulturore, Korça me interlandin e saj, ka trashëguar pasuri me libra të përqëndruara në institucione fetare, arsimore dhe familje të caktuara. Pa u futur në pasurinë bibliotekare të Voskopojës apo edhe të Vithkuqit, biblioteka të hershme ka pasur edhe në fshatra, si: në Boboshticë, Dardhë, Drenovë e gjetiu. Në qytet ka pasur disa biblioteka të vendosura në faltore e në disa shkolla të kohës. Sipas të dhënave të tërthorta, Korça ka pasur bibliotekë publike para vitit 1921. Në bërthamën e atij fondi bënin pjesë edhe librat e shoqërisë "Vatra", të ardhura nga SHBA.⁵

Ai që e dëgjoi zërin e popullit të Korçës, në radhë të parë të rinisë korçare, ishte Thoma Turtulli, i cili vuri në dispozicion të ndërtesës së bibliotekës 200 napolona.⁶ Porsa u dha lajmi, reporteri i gazetës së Korçës shkoi menjëherë të përgëzojë Thoma Turtullin për gjestin e tij mirëbërës kulturor. Atje gjeti disa të rinj të cilët i thanë Turtullit: "Kurrë nuk do të harrojmë emrin tënd, Zoti Thoma, se po na krijon tempullin ku do të shkojmë kohën, që të shpëtojmë nga veset e nga mund të prishemi".⁷ Pastaj gazetari shkoi te prefekti Hilë Mosi, i cili, si njeri i kulturës, mirëpriti me kënaqësi të veçantë ngjarjen e madhe dhe me këtë rast, porositi që të mbledheshin të gjitha thesaret e librave, të cilat mund të ndodheshin andej- këndeje. Pasi u këqyrën projektet e ndryshme që u paraqitën në bashki, midis tyre u pëlqye ai i inxhinier Nastas Pilikës. Porsa u hodh guri i parë i themelit,

Ministri i Arsimit, Xhafer Ypi, i telegrafonte Thoma Turtullit se Krytari i Republikës, A. Zogu, e çmonte veprën e lartë patriotike dhe kishte pranuar propozimin e Ministrisë së Arsimit, për dekorimin e Thoma Turtullit me urdhrin "Komandar i urdhrit Skënderbeut".⁸ Ende pa u mbaruar ndërtesa, Nikolla Lako, që kishte ëndërruar për një bibliotekë në Korçë, e çoi në 25000 volumin e librave të dhuruara, ku bënë pjesë libra në shqip dhe gjuhë të huaja, koleksione hartash gjeografike të Shqipërisë dhe Ballkanit, si edhe foto e gravura me tematikë kombëtare shqiptare.

Pas dy vjet e gjysmë pune, në korrik 1930 ndërtesa e bibliotekës ishte gati. Më 1 gusht 1930, para noterit Mehmet Babani, u nënshkrua akti publik i dhurimit të bibliotekës. Në ditët e para të dhjetorit 1930, u bë përrurimi i bibliotekës. Fjalën e rastit e mbajti drejtori i saj, Nikolla Lako, i cili vuri në dukje se biblioteka që po hapte dyert, do të bëhej vatra e diturisë, e qytetërimit dhe e përparimit. Pasi analizoi shkurt këtë ide, ai falënderoi në emër të popullit të Korçës dhuruesin Thoma Turtulli dhe tha se ai kishte bërë këtë gjest kaq të mirë e të shpejtë, që të gëzonte që me gjallje veprën e tij. Për fat të keq, nuk kaloi dhe një vit nga dita e përrurimit dhe biblioteka u dëmtua nga tërmeti i vitit 1931. Ishte prapë Thoma Turtulli që zgjati dorën bujare, për të bërë shpenzimet e meremetimit.

Në vitet e mëvonshme biblioteka u pasurua më tej. Më 1934 dr. Mihal Turtulli dërgoi nga Selaniku njëqind volume me libra, si dhuratë për bibliotekën e Korçës, ku përfshiheshin libra historike për Shqipërinë, më të shumtat në gjuhë të huaj, por edhe në gjuhën shqipe.⁹

Edhe të huaj patën mirësinë të dhurojnë libra për bibliotekën e Korçës. Konsulli italian në Korçë, Borlengi (Borlenghi), person i respektuar në Korçë, dhuroi enciklopedinë e njohur italiane "Treccani", një vepër me vlera të veçanta. Më pas, me anën e ministrit amerikan në Tiranë, Hugh G. Grant, biblioteka e Kongresit Amerikan i dhuroi bibliotekës së Korçës një sasi librash.¹⁰

Falë pasurisë së bollshme në sasi dhe larmisë tematike të librave, biblioteka e Korçës e drejtuar me kulturë e përkushtim nga veterani Nikolla Lako, vijoi punën.

Përveç punës së rregullt si bibliotekar dhe drejtor biblioteke, me interesimin e tij intelektual, sipas kërkesave dhe nivelit të kohës, Nikolla Lako e kishte kthyer bibliotekën edhe në shkollë arti. Në ditë dhe orë të caktuara në bibliotekë zhvilloheshin disa kurse. Vetë N. Lakoja jepte vizatim. Këtu ai kishte si kolegë Zonjën Lisoni si edhe piktorin e njohur Spiro Xega.¹¹

Një vit pas përrurimit të bibliotekës, Turtujt hodhën një hap tjetër të rëndësishëm mirëbërësie, në fushë të ndihmës shoqërore për fëmijët e paprind.

Në vitin 1919 në Korçë kishte bërë vizitë një komison i Kryqit të Kuq Amerikan, i kryesuar prej zonjës Marie Reynolds Ford. Me përpjekjet e saj, më 10 dhjetor 1919, u themelua jetimorja e parë në Korçë, e vendosur në një shtëpi private me qira. Pas vitit 1920, Kryqi i Kuq Amerikan u largua nga Shqipëria dhe gjithçka ia dorëzoi bashkisë. Mirëpo, një ndërtesë më e madhe se ekzistuesja dhe me kërkesa higjienike e pedagogjike ishte e domosdoshme, sepse atje do të rritnin shtatin dhe do të edukonin karakterin filiza të rinj të privuar nga kujdesi prindëror. Prandaj, kësaj kërkesë iu përgjigj Erasti Turtulli, e veja e Grigor Turtullit, në pranverën e viti 1930 duke qenë gati të përballonte shpenzimet e blerjes së truallit të ndërtimit dhe të pajisjeve të brendshme të godinës. Bashkia mori përsipër projektimin e ndërtesës dhe shpenzimet e tjera anësore.¹² Lajmi për ngritjen e jetimores ngjalli një gëzim të madh popullor. Atje me kohë u grumbulluan jetimë nga Korça, po edhe nga Berati, Shkodra, Kosova, Vlora, Përmeti etj. Për të qenë jetimorja edhe më e plotësuar, fëmijët ishin "nën mbikqyrjen dhe kujdesjen e Thanas Vise Mborjes."¹³

Në vitin 1932, Thoma Turtulli bëri një hap të rëndësishëm përpara. Kur në gusht të atij viti drejtori i përgjithshëm i shëndetësisë, dr. Osmani, bëri një vizitë inspektimi në Korçë, mori premtimin nga Thoma Turtulli për të ngritur një spital në Korçë. Gazeta "Besa" e dha shpejt lajmin e mirë për Korçën dhe për mbarë vendin. Trualli ishte nën bregoren e Shënthanasit, kundrejt kafenesë së Pando Osmanllisë. Në pranverën e vitit 1933 gjithçka ishte gati për fillimin e punimeve. Në një ditë të bukur të majit, shkruante gazeta "Vatra" e Tiranës, "ç'quante

nga flokët e bardhë sa edhe nga shpirti bujar që e cilëson atë, në mes të turmës që po dëshmonte formalitetet e inaugurimit të themelevevet".¹⁴ Kur punimet për ngritjen e ndërtesës së spitalit kishin hyrë në një fazë të rëndësishme, në Parlamentin shqiptar u miratua një ligj për shtesën e një fondi për të balancuar taksën doganore të materialit të sjellë prej Thoma Turtullit nga jashtështetit për ngritjen e spitalit. Më të shumtët e deputetëve gjetën rastin "për të falënderuar nxehtësisht Z. in Thoma Turtulli për veprat mirëbërëse" që po i dhuronte Korçës.¹⁵

Gjatë procesit të ndërtimit për t'iu bërë godinës "çdo gjë e sosur, e saktë dhe e këndshme" shquhej kudo në kthinat e të tri kateve portreti i përhiruar fisnik në kokën thinjoshe të Turtullit".¹⁶ Më 11 korrik 1934, në praninë e përfaqësuesve të qeverisë, të autoriteteve të prefekturës së Korçës dhe të popullit të Korçës, u bë përrurimi i spitalit. Në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë, foli dr. S. Pojani, pastaj përshëndetën kryetari i bashkisë, Rustem Ymeri, drejtori i spitalit, dr. Sali Zavalani, dr. Nikolla Zografi etj."¹⁷ "I pritur me duratrokitje që s'kishin të mbaruar, plaku simpatik, xha Thomai, me lot në sy dhe me zërin që i dridhej nga emocioni, falënderoi përfaqësuesit e qeverisë dhe popullin për mirënjohjen dhe simpathinë që ç'faqnë", për veprën e tij më të re humanitare".¹⁸ Përshtypja që ngjalli te të pranishmit ndërtesa e spitalit për komoditetin dhe bukurinë e saj, ishte impresionante. Jani Martiniani, në një reportazh të "Gazeta e Korçës", nuk përmbahej së vlerësuar cilësinë e punimeve të spitalit, si edhe të pajisjeve dhe mobiljeve, një pjesë e të cilave (kompletimi i një pavioni) ishte dhuratë "prej shoqërisë së kafexhinjëve dhe berberëve" të qytetit.¹⁹ I ngazëllyer nga ato që pa në spitalin "Thoma Turtulli", J. Martiniani e mbyllte me këtë paradoks reportazhin: "Unë, pa ekzagjerim, kur pashë ato dhomat e bukura të mobiluara aq mirë me mobilje të reja, plot diell e dritë dhe që shkëlqejnë nga pastërtia, ta them të vërtetën, ndjeva dëshirën ... të sëmurem që të prehem disa ditë atje."²⁰ Megjithatë, spitalit diçka i mungonte. Korça me klimën e saj, me shumë ditë të ftohta dimërore, kishte nevojë për ngrohje në stinën e dimrit. Këtë e plotësoi e shoqja e mirëbërësit, Athina Turtulli, e cila i dhuroi kryqit të kuq në Korçë një kalorifer me tërë aksesoret

e duhur për spitalin e ri të porsangritur. Ai kalorifer ishte i pari në Korçë me qymyrguri, nga xehtorja e Drenovës.

Duke mbyllur temën e spitalit të Korçës, duhet të shënojmë se ajo pati jehonë më të madhe sesa veprat e mëparshme mirëbërëse të Thoma Turtullit. Gazetat e Tiranës: "Besa", "Vatra", "Shtypi" shkruan më shumë se dhjetë herë për spitalin e Thoma Turtullit. Pra, emri i Th. Turtullit, po bëhej i njohur dhe i nderuar në të gjithë vendin.

Në vitet 1934-1935 Turtulli do ta ngrinte në një shkallë më të lartë veprën e tij mirëbërëse ndriçimtare në udhën e qëndrueshme evolucionare të zhvillimit të Korçës dhe të mbarë vendit. Ishte fjala për ndërtesën e madhe, të bukur dhe solide të Liceut Kombëtar të Korçës, të Shkollës Industriale dhe të përfundimit të katedrales së atjeshme. Pasi dha ndihmën e nevojshme për përfundimin e katedrales, që kishte mbetur prej kohësh, ashtu e pambaruar, Thoma Turtulli vuri në dispozicion të qeverisë shqiptare 40000 fr. ari për Shkollën Industriale të Korçës.²¹ Këtë radhë dhurata e re doli publikisht në emër të bashkëshortes së tij, Athinasë. Gazeta "Besa", me anën e korespondentit të saj në Korçë, bënte të ditur kënaqësinë e veçantë që kishte prodhuar lajmi për ngritjen e ndërtesës së re të Liceut. Ato ditë erdhi shpejt vlerësimi nga Oborri mbretëror. Mbreti Zog dekoroi zonjën Turtulli me Urdhrin e Skënderbeut.

Plani përkatës ishte përgatitur nga Ministria e Punëve Botore, sipas instruksioneve të dhëna nga Ministria e Arsimit në janar 1936. Për të rakorduar përfundimisht me Ministrinë e Arsimit, më 9 mars 1936, Thoma Turtulli, i shoqëruar nga intelektual i njohur korçar, Andon Frashëri, shkoi në Tiranë. Turtulli vuri në dispozicion për ndërmarrjen e re mirëbërëse 300 napolona flori. Ishte fjala për shkollën e mesme më të rëndësishme në Shqipëri, që përmbledhte nxënës nga të gjitha anët e vendit. Me ndërtesën e re shumë më të madhe se e vjetra, po ashtu edhe shumë më cilësore, do të shtohet numri i atyre të rinjve të cilët përgatiteshin për zhvillimin mbarëkulturore të vendit.²² Për fat të keq, çështja po zvarrisej, sepse Ministria e Arsimit kërkonte që të zgjeronte kapacitetet e ndërtesës së projektuar mbi fondin e derdhur nga dhuruesi dhe donte që puna të niste sa më shpejt. Çështjen e zgjidhi prefekti i Korçës,

Mark Kodheli, i cili u mor vesh me Ministrinë e Arsimit që, më vonë, ai dikaster mund të shtonte pavionet e nevojshme, si: laboratorë, salla ngrënie etj.²³

Më 15 prill 1937, me një ceremoni të veçantë, u vu guri i parë në themelet e Liceut.²⁴ Në këtë kohë, revista "Java" e kryeqytetit vlerësonte me superlativat më lavdëruese figurën, tashmë më madhore të mirëbërësisë shqiptare në shekullin XX. "Në rrafshin shoqëror, Thoma Turtulli ishte përjashtim, shkruhej aty, pse ishte më gjenerozi midis gjenezëve, më filantropi midis filantropëve, më altruisti midis altruistëve Nuk e ndiemë veten aq të përgatitur për të lavdëruar shpirtmirësinë e gjerë të mirëbërësit të madh shqiptar Vetëm një gjë mund të themi, duke iu drejtuar njeriut më të pastër Thoma Turtulli: Kombi do të jetë mirënjohës."²⁵

Punët në ndërtesën e Liceut po ecnin me ritëm të shpejtuar në verën e vitit 1937, por, për fat të keq, Thoma Turtulli në gusht ra në shtrat nga bronkopneumonia, për të mos u ngritur më. Kishte marrë të ftohur, kur shkonte shpesh për të ndjekur ecurinë e punimeve në ndërtesën e Liceut. Shqetësimi u përhap shpejt në të gjithë vendin. Me interesimin personal të Mbretit Zog, përveç, nga kryeqyteti, erdhën mjekë specialistë edhe nga Selaniku, por mjerisht, sëmundja kishte përparuar shumë dhe shpresat e shërimit shkonin duke u venitur. Mirëbërësi i madh i mbylli sytë për jetë më 28 gusht 1937. Përveç Liceut, të cilin nuk arriti ta gëzojë ashtu të bukur e të madhërishëm për kohën, i mbeti edhe një peng tjetër: donte të ngrinte në Korçë një shtëpi për pleq.²⁶

Nderimet e fundit iu bënë sipas meritës. Ceremonia e varrimit ishte madhështore në solemnitetin e saj. Një dhimbje të tillë qyteti i Korçës nuk e kishte përjetuar kurrë më parë dhe një funeral si ai nuk e kishte vështruar asnjëherë. Atë ditë, Korça i jepte lamtumirën e fundit birit të saj të madh, kur edhe i gjithë tregu i uli qepenat dhe zyrrat i mbyllën dyert në shenjë zie. Në kryeqytet, N/ kryetari i Parlamentit, Hiqmet Delvina, ndonëse nuk ishte në rendin e ditës të Kuvendit Kombëtar, e mori fjalën dhe tha: "E kanë marrë vesh të gjithë kolegët se Shqipëria, për fat të keq, ka humbur mirëbërësin e saj më të madh, mund të them, të vetmin mirëbërës, mbas independencës shqiptare,

Thoma Turtullin. Nuk them se këtë mirëbërës e humbi vetëm Korça, ky nuk qe vetëm për Korçën, por për të gjithë Shqipërinë. Me mirëbërësinë dhe sakrificën e tij, ai i ka dhënë mësim çdo shqiptari se, kushdo në mos mund të sakrifikojë jetën, në mos mund të bëjë okazion të derdhë gjakun për atdhe, ka edhe mjete të tjera të bëjë detyrën e tij.”²⁷ Pastaj Parlamenti mbajti pesë minuta heshtje në nderim të kujtimit të Thoma Turtullit

Humbja fizike e Thoma Turtullit nuk e uli ritmin e punimeve në ndërtesën e Liceut dhe pas shtatëmbëdhjetë muaj pune, rekord për ritmet e kohës, ndërtesa e Liceut ishte gati. Me rastin e datëlindjes së mbretit Zog, më 8 tetor 1938, u bë përrurimi. Niste një vit i ri shkollor, në një ndërtesë të re, të bukur dhe komode.

Ata që kuptonin dhe dinin të vlerësonin sipas meritës vlerat njerëzore dhe, më në fund, edhe sakrificat e atyre, të cilët nuk kursyen asgjë për të mirën dhe zhvillimin e mëtejshëm të vendit lindor, nuk e harruan kurrë Thoma Turtullin. Ata ditën edhe t’i kundërvihen çdo goje smirëzezë që mërmëriste se, gjoja Thoma Turtulli, në krahasim me pasurinë e tij, nuk kishte bërë ndonjë gjë të madhe. Shadije Alizoti, shkruante nga Korça në gazetën “Drita” të Tiranës: “E vërteta nuk qënkerka ashtu. Veprat e tij (Thoma Turtullit-ig) po të krahasohen me pasurinë, do t’i shtohet akoma më tepër vlefata e sakrificës së tij dhe ndërgjegjes kombëtare njerëzore.”²⁸

Për ta dhënë sa më të kompletuar figurën madhore mirëbërëse të Thoma Turtullit, duhet të shtojmë se ai ka meritë të veçantë edhe për ngritjen e kinemave të para në qytetin e Korçës; pra, për kontribut të drejtpërdrejtë në zhvillimin kulturor të popullit të Korçës. Në vitin 1921, në bashkëpunim me aksionerët Dhimitër Mano dhe Nasi Aristidhi, Thoma Turtulli mori me qira një sallë nga lokalet e Mitropolisë, ku çelën një kinema. E para kinema publike në Korçë me pronarë vendas. Kurse në vitin 1921, Th. Turtulli me Ll. Mborja, Dh. Mano, N. Aristidhi dhe sipërmarrës të tjerë krijuan në Korçë Shoqërinë Anonimë Shqiptare “Cinematro” me një kapital fillestar 120000 fr. ar. Shoqëria pati statutin e saj të aprovuar nga organet e larta përkatëse shtetërore. Më 25 dhjetor 1927 “Cinematro” çeli në Korçë kinemanë e njohur Majestik. Filmi i parë me zë u shfaq

më 21 tetor 1931.²⁹

Si persona të cilët lanë pasuri me testament për arsimin dhe shëndetësinë në qytetin e Korçës, janë edhe dy të tjerë Njëri nga dera Turtulli, senatori Vangjel Turtulli, i cili, sipas një dokumenti të vitit 1940, kishte lënë me testament 10000 fr. shq. për spitalin shtetit në Korçë.³⁰ Me gjallje të tij ka bërë edhe vepra të tjera mirëbërësie, si paja për martesë vajzash të varfëra etj. Kurse tjetri është Kristaq Niko Gjinikasi. Sipas gazetës "Bashkimi i Kombit" të datës 24.12.1943, ai kishte lënë një "testament sekret" për mirëbërje të ndryshme, i cili, po sipas gazetës, u hap pas vdekjes së të shoqes. Më tutje, nuk kemi ndonjë të dhënë tjetër.

Qyteti i Korçës dallohet edhe për mirëbërësi të tjera të organizuara të karakterit kolektiv në të mirë të arsimit dhe kulturës. Këtu më shumë për simbolikën saj, duhet të përmendet ndihma e quajtur "Leku i nxënësit", ku ka një meritë prefekti Ismet Kryeziu. Më shumë se vlera financiare, "Leku i nxënësit" në Korçë, pati vlerën shoqërore e morale: vlerësimin e shkollimit nga familjet e nxënësve. Në të vërtetë, falë punës së ndërgjegjshme të personelit mësimor dhe të vetë prefektit Ismet Kryeziu, leku i vogël i nxënësit bëri punë të madhe në Korçë. Sipas të dhënave të dokumentuara, vetëm gjatë priudhës shtator-dhjetor 1935 u mblodhën 1750 fr. ar., të cilat pjesërisht u depozituan në emër të arsimit të prefekturës. Me ato të holla, ish-shkolla foshnjore e Mitropolisë, u përshtat për palestër dhe në një ceremoni festive të gëzueshme u pagëzua me emrin palestra "Leku i nxënësit".³¹

Një fenomen tjetër origjinal i qytetit të Korçës ishte organizimi i ballove (mbrëmje vallëzim-argëtimi) ku merrte pjesë elita e qytetit me qëllime mirëbërësie.

Ballot ishin një nga traditat më të bukura qytetare korçare, shprehje të një kulture, të organizuara nga bashkia ose prefektura dhe shoqata "Gruaja Shqiptare". Ky qytetërim, arriti në atë kohë, një nga kulmet e tij, kur ballot ishin edhe vepimtari e vyer mirëbërëse ndihmëtare për skamës dhe përgjithësisht për fatkeqë, me të cilët koha dhe fati ishin treguar të pamëshirshëm. Sigurisht, të ardhurat që rridhnin nga ballot për këtë çështje, nuk zgjidhnin dhe nuk mund të zgjidhnin problemet e skamësve,

por gjesti i mirëbërësisë duhet vlerësuar, në radhë të parë, nga këndvështrimi i solidaritetit ndërnjerëzor. Duke përmendur përgatitjet për organizimin e një balloje nga shoqëria voskopojare "Rilindja", "Gazeta e Korçës" shkruante në janar 1932 edhe këto: "Suksesi i madh i ballove të viteve të kaluara, që ka dhënë kjo shoqëri dhe dëfrimi i shkëlqyer krejt familjar, që kanë ndierë gjithë sa kanë marrë pjesë në to, e bën të pritët një ballo me padurim prej gjithë atyre që dëshirojnë të shkojnë një mbrëmje të gëzuar në qejf familjar". Dhe më tutje, duke bërë thirrje për pjesëmarrje, gazeta shtonte: "Pra askush të mos mungojë, se në këtë mënyrë, ndihmon edhe qëllime larta."³² Në dhjetor të vitit 1935, gazeta "Besa" e kryeqytetit bënte këtë koment për një ballo të organizuar nën kujdesin e prefektit Ismet Kryeziu, për të ndihmuar nxënësit e vobektë: "Balloja që u dha më 28 të muajit të kaluar, në sallën "Leku i nxënësit", nën patronazhin e prefektit tonë të mirënjohur Ismet Kryeziu, pati sukses të shkëlqyer, me një numër të madh të ftuarish ...". Pastaj duke lakuar ndjenjën e mirëbërësisë së korçarëve, shtonte: "Me këtë rast u dha edhe një herë mundësia të konstatojmë me kënaqësi se, përgjithësisht, *nër tregëtarët e tregut të madh të qytetit tonë si edhe në popullin korçar, ndjenja e bamirësisë, është e gjallë si ka qenë kurdoherë*, (Corsivi im-ig) mjafton që të merret një iniciativë e mirë e në kohën e duhur dhe ndihma e përkrahja është e sigurtë për gjithnjë."³³

Në vijim të veprimtarive të dalluara mirëbërëse në fushë të arsimit, në fund të viteve "30", u shënua një dukuri e rëndësishme mirëbërëse. Me iniciativën e komisionit shkollor, në bashkëpunim me inspektorinë e arsimit dhe të qendrës higjienike, më 24 janar 1939, u çel mensa për 40 nxënës të vobektë të qytetit. Kryetari i bashkisë, Agathokli Zhitomi, interesohej në mënyrë të veçantë për mensën. Kontributin e parë e dha dega e shoqërisë "Gruaja shqiptare", së bashku me mësuesit e një shkolle që dhuruan rrogën e një dite. Më tej, do të kontribuonin tregtarët e pasur dhe kamës të tjerë korçarë, emrat e të cilëve shënoheshin në librin e nderit të mensës. Shërbimin e bëjnë me radhë vullnetarisht dy mësuese. Po ashtu, doravisht ndante gjellën në kuzhinë, Evanthi Sotir Kota. Duke dhënë lajmin për këtë mirëbërësi të re korçare, gazeta "Drita" e

Tiranës kumtonte në mars të vitit 1939 edhe këto : “Duke dijtur se sa e zhvilluar është ndjenja e bamirësisë në kamësit e Korçës, nuk dyshojmë se këta nuk do të kursejnë ndihmën e tyre të vazhdueshme për drekën e nxënësve të varfër”.³⁴

Përveç ballove si veprimtari kulturore artistike mirëbërëse, Korça zhvillonte shpesh edhe shfaqje të posaçme artistike, me të ardhurat e të cilave bëheshin mirëbërësi të ndryshme. Kështu, në vitet “30” të shek. XX Korça bie në sy për një veprimtari të pasur artistike koncertale me nivel artistik, si në asnjë qendër tjetër të vendit. Aty debutuan artistet dhe artistët, që më vonë do të bëheshin krenaria e artit shqiptar të skenës, si: Tefta Koço (Tashko), Jorgjie Truja (Filçe), Kristaq Antoniu, Lola Gjoka (Aleksi), Mihal Ciko, Llambi Turtulli etj., në bashkëpunim me të palodhurin Sotir Kozmo, si organizator dhe udhëheqës artistik. Po ashtu në Korçë, kishte një traditë të hershme të artit teatral. Atje ishte luajtur tragjedia “Otello” e Shekspirit qysh në vitin 1890. Në teatër dha kontribut të rëndësishëm artisti i mirënjohur, regjizori Sokrat Mio. Në këto veprimtari të gjithë spektatorëve u vendosej në gjoks nga një kordele e vogël kuqezi. Sipas kujtimeve të muzikantit Boris Plumbi, në vitin 1933 shoqata “Gruaja Shqiptare” ndihmoi këngëtarin Kristaq Antoniu për të vijuar një kurs për kanto në Itali.

Në shkurt të vitit 1929, Sotir Kozmoja bëri një koncert për të ndihmuar Lasgush Poradecin, student në Austri, cili ishte i sëmurë në spital dhe ndodhej ngushtë nga buxheti vetjak. Kurse një vit më vonë, Kozmoja organizoi një koncert me korin e nxënësve të Liceut të Korçës, për të ndihmuar shërbëtorët e asaj shkolle, të cilët kishin rrogë të vogël. Në këtë kohë, për Liceun dha ndihmë komuniteti musliman me 6000 fr. ari dhe komuniteti ortodoks me 3000 fr. ari.³⁵

Gjithnjë në ndihmë të arsimit, shënojmë se në janar 1927, drejtorja e internatit të shkollës normale femërore të Korçës, falënderonte shoqërinë e grave të Korçës, e cila u kishte dhuruar jetimëve të atij internati 10 palë këpucë dhe 15 kut (masë gjatësie, baraz me 80 cm) fanellatë për veshjen e tyre.³⁶

Në rrafshin urbanistik, në qytetin e Korçës ka edhe në këtë periudhë disa vepra mirëbërësie, por ne nuk kemi të dhëna të shkruara. Në vitin 1930, Demir Aga Mborja kishte ndërtuar një

tullumb për ujë në pazarin e madh të drithit. Demir Aga, kohë më parë, kishte lënë kujtime të mira kur kishte ndërtuar me shpenzimet tij dy çezma në qytetin e Korçës.³⁷

Përveç mirëbërësve të qytetit, Korça pati edhe mjaft mirëbërës të tjerë në zonat rurale, të cilët që me gjallje, bënë vepra mirëbërësie kryesisht në fushën e arsimit e pastaj edhe për objekte të tjera të rëndësishme të karakterit urbanistik nga persona që e kishin lidhur jetën me fshatin.

¹ Shqipëri e re, Kostancë, 2. 1924, nr. 168.

² Pare - Parea, nga greqishtja: shoqëri, grup shokësh.

³ Posta e Korçës, 31.12.1921, nr. 76.

⁴ Koha, Korçë, 21.05.1921, nr. 44.

⁵ Gazeta e Korçës, 23.03.1926, nr. 269.

⁶ Gazeta e Korçës, 09.01.1926, nr. 311.

⁷ Gazeta e Korçës, 25.09.1926, nr. 315.

⁸ Gazeta e Korçës, 26.07.1927, nr. 398.

⁹ Shekulli i ri, Durrës, 27.07.1928, nr. 554.

¹⁰ Gazeta e Korçës, 04.12.1930, nr. 1119.

¹¹ Gazeta e Korçës, 09.10.1930, nr. 3076.

¹² Po aty.

¹³ Demokracia, Gjirokastër 05.07. 1930, nr. 257.

¹⁴ Zëri i Korçës, 05. 08. 1930, nr. 5231.

¹⁵ Besa, Tiranë, 12.04.1933, nr. 522.

¹⁶ Besa, Tiranë, 25. 01.1933, nr. 714.

¹⁷ Vatra, Tiranë, 09.05.1933, nr. 23.

¹⁸ Besa, Tiranë, 25.11.1933, nr. 714.

¹⁹ Gazeta e Korçës, 13.08.1933, nr. 1749.

²⁰ Besa, Tiranë, 24.03.1934, nr. 810.

²¹ Besa, Tiranë, 08.02.1936, nr. 1374.

²² Besa, Tiranë, 24.11.1934, nr. 1012.

²³ Besa, Tiranë, 21.10.1935, nr. 1284.

²⁴ Besa, 08. 02. 1936, nr. 1374.

²⁵ Arbënia, Tiranë, 30. 4. 1936, nr. 247.

²⁶ AQSH, F. MPB, dok. dt. 20. 9. 1936, nr. 1550.

²⁷ Dielli, Boston, Mass. 07. 06.1937, nr. 5442.

²⁸ Data, Tiranë, 09.03.1938, nr. 390.

²⁹ Hoxha Abaz, *Arti i shtatë në Shqipëri*, Tiranë 1993.

³⁰ AQSH, F. MPB, dok. dt. 20.11.1940, nr. 3713/I. I biri i Vangjel Turtullit Aleko Turtulli vuajti për dhjetë vjet burgjet e diktaturës. E mbylli jetën me vështirësi të mëdha duke punuar si bojaxhi së bashku me të shoqen.

³¹ AQSH, F. MA, 18.07.1935.

³² Shtypi, Tiranë, 12.03.1939, nr. 549.

³³ Gazeta e Korçës, 23.01.1932, nr. 1310.

³⁴ Besa, Tiranë, 10.01.1936, nr. 1348.

³⁵ Zëri i Korçës, 30.12.1930, nr. 565.

³⁶ Gazeta "Besa" Tiranë, 10.01.1936, nr. 1348.

³⁷ Gazeta e re, Tiranë 07.02.1929, nr. 81.